

## **Propozim mbi mbledhjen e ardhshme të KKSHC-së nga anëtarët e shoqërisë civile në KKSHC**

Vitet e fundit organizatat e shoqërisë civile (OSHC) po përballen gjithnjë e më shumë me pengesa serioze kryejnë punën e tyre. Raporte nga institucione, organizatat ndërkombëtare dhe OSHC-të tregojnë se si mjedisi mundësues për shoqërinë civile has ne pamundësi të shumta:

Në shumicën e rasteve, OSHC-të që përfaqësojnë pakicat ose grupet sociale përballen me sfida shtesë - në rastin e organizatave të reja vështirësitë janë ende më të mëdha, duke hequr mënjanë pamundësitë e qëndrueshmërisë financiare poroblemat që lidhen me legjislacionin dhe trajtesen fiskale mbeten ndaj kërkojmë që zgjidhjet të jenë të qënësishme.

Për këtë arsye në mbledhjen e ardhshme të KKSHC-së propozojmë të diskutohet:

1. Rregjistri elektronik i OJF-ve dhe lidhja e tij me sistemin e ri që po përgatitet nga Drejtoria e Tatim Taksave.
2. Zbatueshmëria e Ligjit që përjashton OSHC-të nga detyrimi i TVSH-së.

### **Duke ftuar inistucionet të cilat përgjigjen mbi mbarvajtjen dhe implementimin e masave ligjore dhe financiare të cilat lidhen me**

- Ekzistencën dhe Qëndrueshmërinë e OSHC-ve si dhe lehtësimin e praktikave të punës respektivisht në:
  - a) gjenerimin e ekstraktit të cdo OSHC-je, online, kryjën e ndryshimeve në adresë, emertesë, përfaqësues ligjor online, pa qenë e nevojshme të paraqiten fizikisht pranë Gjykatës së Tiranës
  - b) integrimin e regjistrit elektronik të OSHC-ve në sistemin e ri të Drejtorisë së Tatim Taksave.
  - c) zbatueshmërinë në praktike të ligjit për përjashtimin nga TVSH-ja të OSHC-ve.
  - d) aksesin për të përfituar co-financimin për cdo projekt që financohet nga BE, sikurse ofrohet nga SASPAC për institucionet publike.

#### **Problematikat:**

1. Ndryshimet e bëra në ligjin e TVSH-së të vitit 2014 që lejojnë përjashtime tatimore në vend të rimbursimeve tatimore nuk janë zbatuar ende pasi regjistri elektronik i OJF-ve nuk është i integruar në sistemin e ri të Drejtorisë së Tatim Taksave

Përgatitjet nisën në vitin 2022 për ngritjen e regjistrit elektronik kombëtar të organizatave jofitimprurëse, në përputhje me ligjin e vitit 2021. Është parashikuar që regjistri elektronik të jetë

funksional në fund të vitit 2023 (shih gjithashtu Kapitullin 24 për rekomandimet e FATF). Ndërkohë, organizatat e shoqërisë civile (OSHC) vazhdojnë të regjistrohen në Gjykatën e Rrethit Tiranë sipas ligjit të vjetër të vitit 2001 dhe procesit të gjatë të regjistrimit të tij.

2. Problematiken reale që lidhet me TVSH-në sot referuar sistemit të tatim taksave.

- Taksimi / TVSH per sektorin - diskutime dhe rekomandime.
- Mjedisi mundesues ligjor per sektorin - diskutim
- Udherrefyesi per nje mjedis mundesues - perditetim mbi procesin nga ministria pergjegjese.
- Ligji per perjashtimin e granteve nga TVSH-ja eshte aprovuar tashme. Ligji pasohet me udhезuesin perkates qe qarteson procedurat e zabatimit te tij. OJF-te dergojne tek SASPAC - kontraten e grantit dhe pajisen nga ata me nje certifikate perjashtimi nga TVSH-ja si dhe taksat doganore.
- Certifikata do permbaje nje KOD specifik qe lejon qe cdo subjekt (biznes) qe ofron sherbime/produkte per OJF-te te prese faturen pa TVSH. Me sistemin e fiskalizimit OJF-te faturat e sherbimeve qe ofrojne i presin pa TVSH qe prej momentit qe hyri ne fuqi sistemi i fiskalizimit.
- DPTT qe po punon per sistemin ka nje problem qe lidhet me strukturen e softit si dhe me subjektet qe perjashtohen nga TVSH-ja per grantet. Nuk ekziston sot ne soft hapësira per vendosjen e KOD-it specifik nga ana e bizneseve qe presin faturat per OJF-te pa TVSH.
- Procedura e re-inxhinierimit te softit
- Probleme që lidhen kerkesat që OJF-te pervec kontrates se grantit duhet te dorezojne edhe listen e subjekteve qe kane nenkontraktuar per ekspertize te jashtme, sherbime, pajisje apo punime (ëorks).
- Nisur nga fakti qe gjate implementimit te granteve OJF-te kryejne procedura prokurimi sipas PRAG apo sipas Ligjit Shqiptar ato nuk mund te dorezojne qe ne kerkesen e aplikimit per certifikaten e perjashtimit nga TVSH-ja listen e subjekteve te nenkontraktuara. Shume grante jane me shume se nje vjecare dhe prokurimet kryhen ne periudha te ndryshme te ciklit te projektit.
- Propozimi i DPTT eshte qe nga Ligji i perjashtimit te perfitojne vetem organizatat qe lidhin kontratat e granteve qofshin keto institucione publike apo OJF.
- Probleme që lidhen me gjobat dhe stausi pasiv I organizatave në 7 5-10 vitet e fundit numri i tyre , dhe problem që lidhen cregjistrimin e organizatve

## Kjo kërkesë për ketër ketë prezecë mbështetet në ligjin Nr. 119/2015 PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Neni 7 pika 2 Cdo institucion publik duhet të vërë në dispozicion të KKSHC-së informacionin e kërkuar për financimin e projekteve dhe programeve të OJF-ve dhe OSHC-ve, si dhe çdo informacion që lidhet me mbështetjen e shoqërisë civile.

si dhe ne zbatim të Neni 8 pika 2

I propozon Këshillit të Ministrave programet kryesore për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe përfshirjen e këtij sektori në problematika që lidhen me kryerjen e reformave në fushën ekonomike, sociale, integrimin evropian, respektimin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në vend.

Kjo tryzë do të shërbeje si një tryzë fakt mbledhëse dhe një fotografim I situatës përballë edhe fillimit të vlersimit të masave për udhërrëfyesin e ri të cilat do të shërbejnë edhe si pjesë integrale e rekomandimeve të dala përgjatë këtij procesi por edhe si vijueshmëri e kalendarit të aktiviteteve të miratura në mbledhjen e KKSHC-së 15/11/2022 dhe I relatuar në mbledhjen e dt 19/06/2023 , gjithashtu edhe si një fazë kooediuuese për të përgatitur një raport I cili do të rekomandonte zgjidhjet e përshatshme.

### **Institucionet që ftojmë të marrin pjesë per diskutim ftojmë të jenë:**

- Ministria e Financave
- Drejtoria e Tatim Taksave/ Drejtoria e IT qe po punon me sistemin e ri.
- QKB
- SASPAC
- Keshilli i Gjyqesorit (regjistri elektornik i OJF-ve)

**Për parantezë në dt 24 Prill 2023, u mbajt Takimi Kombëtar** 80 organizata morën pjesë/punuan në mënyrë aktive: 70 prej tyre fizikisht dhe 10 prej tyre përmes platformës ZOOM. Organizatat ishin të strukturave dhe formave të ndryshme si: qendra, shoqata, instute etj.; vendore, kombëtare, përfaqësues rrjetesh, organizata ombrelle, grassroots etj.; me fusha veprimi të ndryshme etj. Përfaqësia gjeografike e organizatave përfshin të gjithë qarqet. Të grupuara, prioritete dhe sfidat mund te përmbliidhen në 4 klastera të mëdhenj të shprehur më poshtë si:

1. **Qendrueshëmria: e diskutuar a) në kuadër të sistemit fiscal; b) në nivel financiar dhe c) në nivelin e veprimtarisë së OJF-së.**
2. Shërbimet e organizatave të Shoqërisë Civile
3. Baza ligjore
4. Dialogu insttucional

Bashkangjitur gjeni të plotë relacion mbi Takimin Kombëtar të Shoqërisë Civile

Dërgimin e ftesave nga ana e sekretariatit në emër të Këshillit.